



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DIBËR

NJESIA E PROKURIMIT

Dibër, më 18.08.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROKURIMIT: Rikonstruktion i shkolles 9-vjecare Dovolani, Bashkia Diber 2025.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Pune ndertimi (45000000-7).

VLERA E FONDIT LIMIT: 19.043.836 (nëntëmbëdhjetë milion e dyzet e tremijë e tetëqind e tridhjetë e gjashtë) leke pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Diber ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

- Sipas kritereve të përgjithshme të kualifikimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit (**2022,2023,2024**), të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre. Nëse operatori ekonomik ofertues është në kushtet e parashikuara nga neni 41, pika "c", e ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 "*Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar*" i ndryshuar, atëherë secili bilanc duhet të shoqërohet me akt-ekspertizën e kryer nga eksperti kontabel.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 "*Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar*" i ndryshuar.

2.2.2. Kopje të deklaratave të xhiros mesatare vjetore, të realizuar nga Operatori Ekonomik ofertues gjatë 3 (tre) viteve të fundit (**2022, 2023, 2024**) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më të vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim

Kjo pike konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin **2024 dhe keestet e maturuara për vitin 2025**, prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës.

Kriteri për pikën 2.2.3 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar, i pari duhet të dorëzojë dokumentacionin provues të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Për QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Për QKR” i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet, lek pa tvsh dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,

ose,

a. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit është **në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.**

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në

kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.1b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit **në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.**

- **Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:**

a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9;
- Kontratë Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Aktin e kolaudit; **(në rastet kur ky dokumentacion lëshohet)**
- Çertifikaten e marrjes në dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim.

Shënim: Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- vertetim leshuar nga subjekti privat shoqëruar me:
- Kontrate Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Aktin e kolaudit; **(në rastet kur ky dokumentacion lëshohet)**
- Çertifikaten e marrjes në dorezim/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim;
- Fatura tatimore të situacionit përfundimtar

Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë:

- Kontraten e bashkimit te operatoreve dhe prokuren e posacme te deklaruar ne fazen e tenderimit;
- Per kontratat e realizuara si Nenkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë:

a) Kontratë baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe

b) Miratimin zyrtar si nenkontraktor nga ana e Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50% të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Stafi kryesor e mbështetës, punonjësit, certifikimet, i kualifikuar për keto punime.

a) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij si drejtues teknik të shoqërisë, inxhinierët e mëposhtëm:

- Inxhinier Ndertimi 1 (nje)
- Inxhinier Topograf ose Gjeodet 1 (nje)
- Inxhinier Hidroteknik 1 (një)
- Inxhinier Elektrik 1 (një)
- Inxhinier mekanik 1 (një)

Inxhinierët e sipërcituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në licensën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesat e shoqërisë për të paktën periudhën **MUAJIN E FUNDIT**. Për inxhinierët duhet të paraqiten: Diploma, Kontratë individuale pune (*e vlefshme*).

Shenim: Kriteri për piken 2.3.2 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar, i pari duhet të dorëzojë dokumentacionin provues të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Vendosja e këtij kriteri për fuqinë punëtore është bërë në përputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit të punimeve sipas grafikut të punimeve, që është perlllogaritur në një kohë të shkurtër i cili kërkon fuqi punëtore të shtuar dhe me mjetet e kërkuara për zbatimin me sukses të kësaj kontrate.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të ketë fuqi minimale punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, me një numër prej mesatarisht **40 (dyzet) punonjës**.

Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.8. Ndërsa operatori ekonomik fitues, para lidhjes së kontratës, duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën **tre mujorin e fundit**.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **tre mujorin e fundit**

Kriteri për piken 2.3.3 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar, i pari duhet të dorëzojë dokumentacionin provues të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Vendosja e këtij kriteri për fuqinë punetore është bërë në përputhje me zerat dhe volumnet e preventivit, me afatin e zbatimit të punimeve sipas grafikut të punimeve, që është perlllogaritur në një kohë të shkurtër i cili kërkon fuqi punetore të shtuar dhe me mjetet e kërkuara për zbatimin me sukses të kësaj kontrate

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij specialistë të certifikuar sipas profesioneve, të pakten si më poshtë:

- Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht **2 (dy)** punonjës **shoferë**, për të cilët duhet të paraqesë kontratë individuale pune të vlefshme, Dëshmi Aftësie Profesionale (të vlefshme), lëshuar nga institucionet perkatese, si dhe të figurojnë në lispagesat e shoqërisë për të pakten periudhën **muajin e fundit**
- Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht **1 (një)** teknik ndërtimi , për të cilët duhet të paraqesë kontratë individuale pune të vlefshme, Dëshmi Aftësie Profesionale (të vlefshme) ose diploma, dëshmi të sigurimit teknik (të vlefshme), si dhe të figurojnë në lispagesat e shoqërisë për të pakten **muajin e fundit**
- Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht **2 (dy)** elektrikist , për të cilët duhet të paraqesë kontratë individuale pune të vlefshme, Dëshmi Aftësie Profesionale (të vlefshme) ose diploma, dëshmi të sigurimit teknik (të vlefshme) , si dhe të figurojnë në lispagesat e shoqërisë për të pakten periudhën **muajin e fundit**
- Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht **2 (dy)** hidraulik, për të cilët duhet të paraqesë kontratë individuale pune të vlefshme, Dëshmi Aftësie Profesionale (të vlefshme) ose diploma, dëshmi të sigurimit teknik (të vlefshme) , si dhe të figurojnë në lispagesat e shoqërisë për të pakten periudhën **muajin e fundit**
- Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht **1 (një)** punonjës, kaldaist për të cilët duhet të paraqesë kontratë individuale pune të vlefshme, Dëshmi Aftësie Profesionale (të vlefshme) ose diploma, dëshmi të sigurimit teknik (të vlefshme) si dhe të figurojnë në lispagesat e shoqërisë që ofron shërbimin për të pakten periudhën **muajin e fundit**
- Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht **2 (dy)** karpentier, për të cilët duhet të paraqesë kontratë individuale pune të vlefshme, Dëshmi Aftësie Profesionale (të vlefshme) ose diploma, si dhe të figurojnë në lispagesat e shoqërisë për të pakten periudhën **muajin e fundit**

- Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht **1(nje)** murator, per te cilet duhet te paraqese kontrate individuale pune te vlefshme, Dëshmi Aftësie Profesionale (te vlefshme) ose diploma, si dhe te figurojne ne lispagesat e shoqerise për të pakten periudhën **muajin e fundit**
- Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht **3 (tre)** suvatues, per te cilet duhet te paraqese kontrate individuale pune te vlefshme, Dëshmi Aftësie Profesionale (te vlefshme) ose diploma, si dhe te figurojne ne lispagesat e shoqerise për të pakten periudhën **muajin e fundit**
- Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht **2 (dy)** bojaxhi, per te cilet duhet te paraqese kontrate individuale pune te vlefshme, Dëshmi Aftësie Profesionale (te vlefshme) ose diploma, si dhe te figurojne ne lispagesat e shoqerise për të pakten periudhën **muajin e fundit**
- Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht **3 (tre)** Shtrues pllakash dhe të tjerë që lidhen me to, per te cilet duhet te paraqese kontrate individuale pune te vlefshme, Dëshmi Aftësie Profesionale (te vlefshme) ose diploma, si dhe te figurojne ne lispagesat e shoqerise për të pakten periudhën **muajin e fundit**
- Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht **1(nje)** hidroizolues, per te cilet duhet te paraqese kontrate individuale pune te vlefshme, Dëshmi Aftësie Profesionale (te vlefshme) ose diploma, si dhe te figurojne ne lispagesat e shoqerise për të pakten periudhën **muajin e fundit**
- Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht **1 (nje)** mekanik, per te cilet duhet te paraqese kontrate individuale pune te vlefshme, Dëshmi Aftësie Profesionale (te vlefshme) ose diploma, si dhe te figurojne ne lispagesat e shoqerise për të pakten periudhën **muajin e fundit**
- Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht **2 (dy)** betonues, per te cilet duhet te paraqese kontrate individuale pune te vlefshme, Dëshmi Aftësie Profesionale (te vlefshme) ose diploma, si dhe te figurojne ne lispagesat e shoqerise për të pakten periudhën **muajin e fundit**
- Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht **1 (nje)** Teknik ose Specialist IT/ komunikimi /elektronik/informatik per te cilin duhet te paraqese kontrate individuale pune te vlefshme, Dëshmi Aftësie Profesionale (te vlefshme) ose diploma, dëshmi te sigurimit teknik (te vlefshme) si dhe te figurojne ne lispagesat e shoqerise për të pakten periudhën **muajin e fundit**

Shënim: Kriteri per piken 2.3.4 konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar, i pari duhet të dorëzojë dokumentacionin provues të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Vendosja e këtij kriteri për fuqinë punetore është bere ne perputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit te punimeve sipas grafikut te punimeve, qe është perlllogaritur ne nje kohe te shkurter i cili kerkon fuqi punetore te shtuar dhe me mjetet e kerkuara per zbatimin me sukses te kesaj kontrate

2.3.5 Operatorët ekonomikë duhet të përcaktojnë me anë të një deklaratë nga (Administratori i shoqërisë), Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë, dhe që do të sigurojë drejtimin teknik të punimeve në kantier dhe nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera. Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt , i deklaruar duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara në Udhëzimin nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”

(Ne rastin e Bashkimit te Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet te përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe te jetë i pranishem gjate gjithe kohes qe do te kryhen punimet ne objekt ne varesi te vleres se preventivit te punimeve qe ka marre persiper sipas përqindjes se bashkepunimit).

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar mjekun e shoqërisë i cili të ketë kontratë pune, diplomë, licensë Urdhër Mjeku dhe të figurojë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues, ose duhet të paraqitet një kontratë e vlefshme për ofrimin e këtij shërbimi me një subjekt të licensuar, sipas ligjit. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, secili nga operatorët ekonomikë duhet ta plotësojë këtë kusht në përputhje me numrin respektiv të punonjësve sipas kërkesave ligjore.

- Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të 2(dy) punonjës të trajnuar/certifikuar për punimet në lartësi. Për këtë duhet të paraqesë: certifikata trajnimi për “Punimet ne lartesi D.P.I., Rënia nga lartësitë, Punimet në lartësi D.P.I. skela, shkallë, skarpate etj” e dhenë nga një organizëm certifikimi i akredituar shqiptar ose i huaj dhe të figurojnë në listëpagesat **muajin e fundit**
- 1 (një) punonjes i pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga shoqeri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, shoqëruar me kontratë

individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë **muajin e fundit**

(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave").

- Operatori/ët ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 1 (nje) specialist Ekspert Zjarrfikës me certifikate PMNZSH ne fushen e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin në përputhje me klauzolat Ligjit Nr. 152/2015 "Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin", Neni 49, pika 4, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë **muajin e fundit**
- Operatori ekonomik ofertues duhet të provojë se ka të punësuar 1 (një) punonjës të trajnuar/certifikuar si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë”. Për këtë duhet të paraqesë certifikatë trajnimi e dhenë nga një organizëm certifikimi i akredituar shqiptar ose i huaj.

Shënim: Kriteri per piken 2.3.6 konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar, i pari duhet te dorëzoje dokumentacionin provues të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Vendosja e këtij kriteri per fuqine punetore eshte bere ne perputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit te punimeve sipas grafikut te punimeve, qe eshte perllogaritur ne nje kohe te shkurter i cili kerkon fuqi punetore te shtuar dhe me mjetet e kerkuara per zbatimin me sukses te kesaj kontrate

2.3.7 Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës.

Operatori ekonomik ofertues, duhet të dëshmojë se dispononë liçense profesionale për zbatim punimesh në ndertim, duke perfshire kategorite e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërise, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojne veprimtari ndertimi”, i ndryshuar.

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

- **N.P - 1 A** Punime gjurmimi në tokë;
- **N.P - 3 A** Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash
- **N.P - 7 A** Ujësjetës, gazsjellës, vajsjetës, vepra kullimi e vaditje
- **N.P - 11 A** Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.

Për punimet special të ndërtimit :

- **N.S - 1 A** Punime për prishjen e ndërtimeve
- **N.S - 2 A** Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre;
- **N.S - 4 A** Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtues;
- **N.S - 12 A** Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit;
- **N.S - 14 A** Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV.
- **N.S - 18 A** Punime topogjeodezike
- **sipas modelit të lëshuar nga MPPT/MTI;**

Për operatorët e huaj të bëhet njëhësimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Shoqëritë e huaja duhet të kenë kryer ekuivalentimin (*njëhësimin*) e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë kompetente të ngarkuar me ligj në Republikën e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, sipas preventivit bashkëngjitur në SPE.

2.3.8 Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencën profesionale nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) Kodi III.2.B “ Grumbullim dhe transportim i mbetjeve inerte dhe dhera si mbetje të parrezikshme ” . Mbështetur në: Ligj Nr. 9010, datë 13.02.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”(Ndryshuar me Ligjin Nr 10137, datë 11.05.2009 “Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”)Kreu II N.9 N. 12 N. 24/1 N. 25.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e

Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë kapacitetet e duhura profesionale dhe organizative për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.9 Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, për objektin që prokurohet, të cilat duhet të jenë të perkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara, sipas standardeve:

- **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë (të vlefshme) “ose ekuivalent;
- **ISO 45001:** - Sistemi i Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në punë ose ekuivalente;

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të vlefshme dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion mjetet e pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, si më poshtë (sipas formularit përmbledhës të vetedeklarimit):

1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes mbi 12 ton	Në pronësi ose me qera	1
2	Kamioncine me kapacitet mbajtes deri 3.5 Ton	Në pronësi ose me qera	1
3	Autovinç	Në pronësi ose me qera	1
4	Kamion me kapacitet mbajtes jo më pak se 10 ton	Në pronësi ose me qera	2
5	Autobetoniere	Në pronësi ose me qera	1
6	Autobot uji	Në pronësi ose me qera	1
7	Kompresor	Në pronësi ose me qera	1
8	Gjenerator	Në pronësi ose me qera	1
9	Depozite uji kapaciteti min 2000 l	Në pronësi ose me qera	1
10	Saladtrice	Në pronësi ose me qera	1
11	Fabrike Nyje/Inerte	Në pronësi ose me qera ose kontrate furnizimi	1

12	Cekic Peneumatik	Në pronësi ose me qera	1
13	Vibrator betoni	Në pronësi ose me qera	1
14	Skeleri fasade	Në pronësi ose me qera	500m2
15	Tokmak	Në pronësi ose me qera	1
Nr	Mjete mbrojtëse	Në pronësi ose me qera	Sasia
1	Kokore	Në pronësi ose me qera	40 cope
2	Jelek	Në pronësi ose me qera	40 cope
3	Tabela Sigurimi Teknik	Në pronësi ose me qera	10 cope
4	Fikse Zjarri	Në pronësi ose me qera	5 cope
5	Kuti Ndhme e shpejt	Në pronësi ose me qera	5 cope

Operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion pajisjet teknike (pronësi ose me qera), të nevojshme për ekzekutimin e kontratës si më poshtë (sipas formularit përmbledhës të vetedeklarimit):

- Për makineri teknologjike dhe mjete që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që verteton pronësinë e mjetit: çertifikatë pronësie, leje qarkullimi, çertifikatë e kontrollit teknik, siguracionin;
- Ndërsa për makineri teknologjike dhe mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës;
- Për makineri teknologjike dhe mjete që nuk shënohen në regjistra publikë (makineritë teknologjike), kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse.
- Ndërsa për makineri teknologjike dhe mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë (bashkëngjitur faturë zhdoganimi ose faturë tatimore blerje) dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës;
- Për pajisjet kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontratë blerje/faturë zhdoganimi/faturë tatimore blerje.
- Ndërsa për pajisjet e marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë (bashkëngjitur faturë zhdoganimi/faturë tatimore blerje) e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës.
- Për makineritë teknologjike dhe mjetet, fotoja duhet të ketë të dallueshme edhe targën e mjetit.

- h) Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruar në procedura të shpallura fitues.
- i) Per Fabrikat e prodhimit te betonit /inerteve OE duhet te paraqesin kontratë furnizimi (Kontrata Nateriale e Qerasë/Furnizimit)

Shënim: *Shënim: Kriteri per piken 2.3.11 konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT.*

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar, i pari duhet te dorëzoje dokumentacionin provues të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave te preventivit dhe specifikimeve teknike te hartuara nga specialistet e fushes

2.3.11 Operatori Ekonomik duhet të disponojë:

a- Ne Pronesi / Kontrate Qeraje/ Kontrate Shërbimi me nje laborator testimi të materialeve kryesore të ndertimit beton, hekur, i cili duhet të jetë i akredituar nga organizma kombetar ose nderkombetar sipas standarteve SSH EN 12390-3:2019, SSH EN 12350-2:2019 dhe SSH EN 12504-2:2012 e vlefshme për të gjithë periudhen e realizimit të kontrates objekt i këtij prokurimi. (Në rastet e bashkimit të ekonomikë, dokumentat e mësipërme duhet ti paraqesë të pakten njeri nga anëtarët e grupit).

b- Ne perputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit perkates , operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim /kontrate bashkepunimi nga prodhuesi / distributor , me të cilin prodhuesi / distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto pajisje / mallra në këtë procedurë prokurimi , si më poshtë:

2. Materiale elektrike
3. Materialet hidraulike
4. Bojra
5. Materiale hidroizoluese
6. Materjale Shtresash Pllaka
7. Materjale Suvatimi
8. Pllaka

2.3.12 Grafiku i punimeve.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Bazuar ne vkm 285 date 19.05.2020 Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”i ndryshuar,neni 26 pika 1.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike jane hartuar nga projektuesi, bashkengjitur DST ne SPE.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Njesia e prokurimit: